



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË FERIZAJT PËR VITIN 2021

**Prishtinë, maj 2022**

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Ferizajt për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Ferizajt (K.F), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Ferizajt, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

## Baza për Opinion të Kualifikuar

Çështjet material që kanë ndikuar opinionin janë si në vijim:

- A1 Keqklasifikimi i shpenzimeve në kategori ekonomike në vlerë 694,046€.
- A2 Detyrimet kontingjente të prezantuara në Raportin Vjetor Financiar (neni 18), ishin të mbivlerësuara për 16,750€.
- B1 Prezantim jo i saktë i pasurive në PFV për shkak të nënvlerësimit për 2,157,615€, si dhe mos regjistrimi dhe mos aplikimi i sistemit e-pasuria për pasuritë nën 1,000€, duke bërë që vlera e pasurive kapitale dhe jo kapitale të mos jetë e shpalosur saktë në PFV.
- B2 Prezantim jo i saktë i Lloagarive të Arkëtueshme në PFV për 1,435,171€.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, për shkak të rëndësisë së çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të Komunës së Ferizajt nuk kanë qenë në përputhje me:

### Baza për konkluzion

- A3 Komuna te projekti Riparimi i trotuareve me kubëza kishte shpërblyer me kontratë operatorin ekonomik (OE) i cili nuk i kishte plotësuar të gjitha kriteret e përcaktuar me dosje të tenderit.
- A4 Komuna kishte përdorur procedurë të negociuar për projektin Rregullimi i kanalizimit në fshatin Kosinë me arsyetimin se problem i kanalizimit në fshatin Kosinë ishte emergjent, edhe pse KRPP kishte dhënë një opinion se komuna nuk duhet të përdor procedurë të negociuar sepse problemi me kanalizimin në fshatin Kosinë ishte për komunën nga viti 2013.
- A5 Komuna nuk kishte përgatitur plan vjetor për subvencionimin e OJQ-ve.
- A6 Në tetë (8) pagesa të testuara në vlerë 390,696€, kemi identifikuar se komuna ka përdorë fondet nga projektet për qëllime tjera nga ajo për të cilin ishin planifikuar, pa i zbatuar procedurat dhe kriteret për transferim dhe rialokim të ndarjeve buxhetore nga një projekt kapital në një tjetër.
- B3 Si pasoj e vonësës në pagesën e detyrimeve financiare komuna ishte detyruar të paguante shpenzime shtesë prej 550,082€ në emër të procedurës kontestimore/përmbartimore apo interesit për pagesë të vonuar.
- B4 Komuna nuk kishte arritur që të bëjë verifikimin e 20% të pronave të tatueshme dhe nuk ka bërë shqyrtimin e ankesave brenda afatit të përcaktuar kohor.
- B5 Komuna gjatë vitit 2021 kishte angazhuar 41 zyrtarë për shërbime të veçanta. Të gjithë punëtorët e angazhuar, janë kontraktuar pa udhëhequr procedurë të prokurimit.
- B6 Në nëntë (9) raste kemi vërejtur që, menaxherët e kontratave nuk kishin përgatitur planin për menaxhimin e kontratës.
- B7 Komuna gjatë vitit 2021 nuk kishte arritur që ti regjistroj edhe 22 të punësuar në listën e pagave të cilët kishin kontrata të rregulta të punës.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

## **Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore**

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Ferizajt.

## **Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë**

Menaxhmenti i Komunës së Ferizajt është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Ferizajt në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

## **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Ferizajt me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë

përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.

- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Ferizajt.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, ne kemi vërejtur fusha ku nevojiten përmirësime të mundshme, rreth menaxhimit financiar dhe Kontrollit. Dobësi evidente janë vërejtur në fusha të rëndësishme financiare si: te të hyrat, mos respektimi i procedurave të prokurimit, menaxhimit e të arkëtueshmeve, mos prezantimi i saktë i detyrimeve kontingjente në PFV, keqklasifikimi i shpenzimeve në kategori jo adekuate, si dhe dobësitë në menaxhimit e pasurive, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimit e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

PFV-të e Komunës të përgatitura me datë 31.01.2022 për vitin e përfunduar me 31.12.2021, nuk ishin në pajtim me Rregullën Financiare nr.01/2017. Ato ishin jo të plota dhe të pasakta, prandaj gjatë procesit të auditimit kemi sugjeruar menxhmentin e komunës që PFV-të të korrigjohen. Më tutje, pasqyrat janë korrigjuar dhe dorëzuar në ZKA, dhe në Thesar. Megjithatë, çështjet e shpalosjes së plotë të pasurive, llogarive të arkëtueshme, detyrimeve kontingjente dhe keq klasifikimi i shpenzimeve kanë mbetur me gabime gjë që të njëjtat i kemi trajtuar si çështje që ndikojnë në opinionin e auditimit.

Ky raport ka rezultuar me 23 rekomandime, prej tyre 13 janë rekomandime të reja dhe dhjetë (10) të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

## 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

### Çështja A1 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve

#### Gjetja

Sipas Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF “Shpenzimi i parasë publike” shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël, po ashtu me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë.

Në nëntë (9)<sup>4</sup> raste kemi identifikuar se ishin ekzekutuar pagesa në kategori jo adekuate në vlerë prej 694,046€. Prej tyre, tre (3) pagesa janë kryer nga komuna dhe gjashtë (6) pagesa direkte nga thesari:

- Nga kategoria e investimeve kapitale, 237,544€ ishin paguar për mallra dhe shërbime;
- Nga kategoria mallra dhe shërbime, 405,373€ ishin paguar për investime kapitale dhe 5,047€ për subvencione dhe transfere; dhe
- Nga subvencione dhe transfere, 46,082€ ishin paguar për investime kapitale.

Kjo ka ndodhur për shkak se komuna nuk kishte bërë planifikim adekuat sipas nevojave dhe kërkesave të raportimit të shpenzimeve sipas kategorive përkatëse.

#### Ndikimi

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve nga kategoritë ekonomike jo adekuate, ndikon në mbivlerësimin/nënvlerësimin e kategorive përkatëse të shpenzimeve dhe të pasurive. Si rrjedhojë ndikon në prezantim jo të drejtë të shpenzimeve në Pasqyra Vjetore Financiare.

#### Rekomandimi A1

Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestini i mjeteve dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate të përcaktuara me plan kontabël.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### Çështja A2 - Mbivlerësim i detyrimeve kontigjente

#### Gjetja

Neni 6 i Rregullores MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore parasheh se: “Organizatat buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare”.

Nga shtatë (7)<sup>5</sup> raste të testuara është identifikuar se Komuna kishte prezantuar në listën e detyrimeve kontigjente vendimin e plotë fuqishëm të gjykatës prej 16,750€ për paga jubilarë, shpenzimet e shujtave dhe shpenzimet e udhëtimit të punëtorëve të arsimit, duke mbivlerësuar detyrimet kontigjente.

Prezantimi jo i drejtë i detyrimeve kontigjente në PVF kishte ndodhur për shkak se nuk kanë funksionuar kontrollet e brendshme në mes të personit përgjegjës për mbajtjen e regjistrit të detyrimeve kontigjente dhe ZKF-së,



me rastin prezantimit të tyre në PVF.

**Ndikimi** Prezantimi i detyrimeve kontingjente në vlera jo të sakta ndikon në mbivlerësimin e tyre, si dhe palët e interesit apo shfrytëzuesit e PFV të mos informohen drejtë dhe saktë lidhur me vlerën e detyrimeve kontingjente.

**Rekomandimi A2** Kryetari duhet të sigurojë se detyrimet financiare të prezantohen në pasqyrat financiare sipas kërkesave të rregullores për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B1 - Mos regjistrimi i pasurive dhe prezantimi jo i plotë i tyre në PFV**

**Gjetja** Sipas Rregullores Nr. 02/2013 - "Për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore", neni 6, pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin "e-pasuria", po ashtu neni 6 i Rregullores Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore parasheh se: "Organizatat buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare".

Komuna nuk kishte regjistruar në regjistrat kontabël të SIMFK-së blerjet<sup>6</sup> e vitit 2021 që janë bërë për pasuri kapitale dhe jo kapitale në vlerë prej 2,134,373€ (ku përfshihen asfaltimi i rrugëve lokale, ndërtimi i objekteve arsimore dhe shëndetësore, etj). Në anën tjetër, pagesa për blerjen e tokës prej 8,858€, në regjistrin e pasurive ishte regjistruar në vlerë 32,100€ duke mbivlerësuar tokat për 23,242€.

Komuna që pesë (5) vite nuk është duke e aplikuar sistemin e-pasuria për regjistrim të pasurisë jo kapitale nën 1,000€ dhe për pasojë këto pasuri nuk kishin vlerë të shpalosur në PFV. Për më tepër, edhe për pasuritë e blera gjatë vitit 2021, nuk ka asnjë lloj evidence as në Excel, ndërsa sipas evidencave të thesarit shpenzimet e bëra për (kodet e pasurive nën 1,000€) për vitin 2021 ishin 33,699€ kurse për vitin 2020 ishin në shumë 208,890€.

Zyrtarët nuk kanë ofruar shpjegime për mos zbatim të kërkesës ligjore. Megjithatë, ndonëse rekomandimi përsëritet, komuna nuk ka treguar interesim që të ndërmar masa për përmirësimin e gjendjes aktuale me qëllim që të evitohen gabimet e përsëritura.

**Ndikimi** Mos regjistrimi i të gjitha pasurive, rritë rrezikun që komuna mos të ketë nën kontroll, të gjitha asetet e saj dhe të ketë mangësi në raportim duke bërë nënvlerësimin e pasurive në PFV.

**Rekomandimi B1** Kryetari duhet të sigurohet se të gjitha pasuritë regjistrohen në regjistrin e pasurisë në mënyrë që të ulet rreziku i keqpërdorimit apo humbjes së pasurisë. Po ashtu, kryetari duhet të sigurojë se janë regjistruar të gjitha pasuritë nën 1000€ dhe që sistemi e-pasuria të funksionalizohet.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja B2 - Prezantim jo i saktë i llogarive të arkëtueshme në PFV****Gjetja**

Neni 6 i Rregullores Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore parasheh se: “Organizatat buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare”.

Sipas Ligji Nr. 06/L005 për tatimin në pronën e paluajtshme, neni 10 në pikën 10.1 përcakton se: 1. Tatimi në pronën e paluajtshme nuk do të vendoset në pronën e paluajtshme e cila është në pronësi ose posedim të: 1.1. institucioneve publike të Republikës së Kosovës.

Komuna ka bërë prezantim jo të saktë të llogarive të Arkëtueshme (LI.A) në PVF për 1,435,171€ për gabimet e hasura si më poshtë:

- Nuk ka përfshirë në PFV-të LI.A nga taksa për veprimtari në biznes prej 354,209€, të cilat datojnë nga viti 2001 deri 2009. Më tutje, për 11 (njëmbëdhjetë) mostra të përzgjedhura për auditim të kësaj takse, është ofruar vetëm regjistri nga kjo llogari, komuna nuk ishte në gjendje të ofroj dokumente, me arsyetimin se nuk i kanë faturat dhe vendimet sepse janë asgjësuar pasi shumica prej tyre janë borgje të vjetra;
- Po ashtu LI.A janë mbivlerësuar për 872,402€ për dy<sup>7</sup> prona të cilat janë në pronësi të institucioneve të Republikës së Kosovës. Pronat të cilat janë në pronësi apo posedim të institucioneve të Republikës së Kosovës janë të liruara nga tatimi në pronë; dhe
- LI.A për shfrytëzimin e pronës komunale janë të nënvlerësuar për 208,560€, pasi që komuna nuk ka shpalosur LI.A nga Shoqatat e dala nga lufta dhe shoqatës së të burgosurve politik, të cilat e kishin në shfrytëzim pronën publike.

Kjo ka ndodh pasi që Komuna nuk ka një bazë të të dhënave ku mbahen shënimet e të gjitha LI.A, poashtu nuk ka një komunikim të vazhdueshëm në mes drejtorisë së financave, ZKF dhe drejtorive që mbledhin të hyra, si dhe funksionimi jo efikas i kontroleve të brendshme në azhurnimin e regjistrave kontabël dhe ruajtjen e dokumentacionit. Lidhur me tatimin në pronë, Komuna me një shkresë të datës 21 janar 2020, kishte njoftuar Departamentin e Tatimit në Pronë se kjo pronë është pronë komunale dhe nuk duhet të ngarkohet me tatim në pronë.

**Ndikimi**

Prezantimi i LI.A në vlera jo të sakta ndikon që palët e interesit apo shfrytëzuesit e PFV të mos informohen drejtë dhe saktë lidhur me vlerën LI.A.

**Rekomandimi B2**

Kryetari duhet të sigurojë se zyrtarët përgjegjës mbajnë evidenca të sakta për llogaritë e arkëtueshme dhe Zyrtari Kryesor Financiar duhet të sigurohet se prezantimi i tyre në PFV është i saktë. Po ashtu, të komunikojë me Departamentin e Tatimit në Pronë, që obligimi i tatimit në pronë për objektet komunale të shlyhet.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

### Çështja A3 - Kontraktimi i OE pa përmbushur kriteret

#### Gjetja

Sipas neni 56.4 të LLP, Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Tek kontrata kornizë Riparimi i trotuareve me kubëza me Nr. 656-20-174-2-1-1 me vlerë të parashikuar 250,000€, Operatori Ekonomik (OE) fitues nuk i kishte plotësuar të gjitha kriteret e përcaktuara me dosje të tenderit, nuk kishte ofruar dëshmi se ka një person të certifikuar për quality manager ISO 9001-2015, dhe një person të certifikuar për siguri dhe shëndet në punë OHSAS 18001 2007.

Zyrtarët nuk kanë ofruar ndonjë shpjegim për mos zbatim të kërkesës ligjore.

#### Ndikimi

Kontraktimi i OE pa i përmbushur kriteret, eliminon mundësinë e një procesi të mirëfilltë të prokurimit, e cila mund të përjashtoj nga procesi OE të përgjegjshëm dhe mund të ndikoj që kontrata të mos realizohet.

#### Rekomandimi A3

Kryetari duhet të sigurojë kontrollin e duhur përmes zyrës së prokurimit në mënyrë që komisionet e vlerësimit të tenderëve bëjnë vlerësim dhe krahasim të drejt të ofertave, po ashtu, të rishikoj procesin dhe të siguroj se është përzgjedhur OE i përgjegjshëm.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### Çështja A4 - Përdorimi i procedurës së negociuar pa plotësuar kriteret

#### Gjetja

Sipas nenit 35.2 të LPP, Autoriteti kontraktues mund të përdor procedura të negociuara pa publikimin paraprak të njoftimit të kontratës për ushtrimin e aktiviteteve të prokurimit që kanë për qëllim dhënien e: nëse, për aq sa është shumë e nevojshme për arsye të emergjencave ekstreme që janë shkaktuar nga ngjarje objektivi të verifikueshme të cilat nuk kanë pasur mundësi të parashikohen me arsye nga autoriteti përkatës kontraktues, autoriteti i tillë kontraktues nuk mund ta japë kohën e kërkuar për ushtrimin e cilësdo procedurë tjetër që parashtrohet në këtë ligj. Me kusht që kjo dispozitë të mos mund të shfrytëzohet nëse rrethanat që e kanë krijuar situatën emergjente ekstreme mund t'u atribuohen veprimeve neglizhente ose të qëllimta ose lëshimeve të autoritetit kontraktues.

Për projektin "Rregullimi i kanalizimit në fshatin Kosinë", komuna kishte lidhur kontratë me procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit në vlerë 213,953€. Komuna kishte përdorur procedurë të negociuar me arsyetimin se problemi i kanalizimit në fshatin Kosinë ishte emergjent, edhe pse KRPP kishte dhënë një opinion se komuna nuk duhet të përdor procedurë të negociuar për këtë projekt, pasi që, nuk janë plotësuar kushtet si përcaktohen në nenin 35 të LPP. Kjo procedurë nuk ishte urgjente, pasi që

problemi me kanalizimin në fshatin Kosinë ishte nga viti 2013.

Zyrtarët komunal nuk kanë ofruar ndonjë sqarim adekuat për mos zbatim të kërkesës ligjore. Komuna këtë projekt ndonëse e kishte vendosur në planin e saj në vitin 2020, nuk kishte arritur ta realizoj, kurse në vitin 2021 nuk e kishte planifikuar fare.

**Ndikimi** Mos aplikimi i procedurave të hapura të prokurimit, ka bërë që të kufizohet konkurrenca dhe transparencja për shpenzimin e parasë publike dhe të rris rrezikun që komuna të marrë produkte me çmime jo të favorshme.

**Rekomandimi A4** Kryetari duhet të sigurojë se shpenzimi i parasë publike për blerjen e shërbimeve punëve apo produkteve të bëhet sipas procedurave adekuata të prokurimit për konkurrencë të barabartë dhe transparente në mënyrë që të arrihet vlera për parën e shpenzuar.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja A5 - Mos përgatitja e planit vjetor për mbështetje financiare / subvencionim**

**Gjetja** Rregullorja MF Nr. -04/2017- për subvencionimin e OJQ-ve, ka përcaktuar procedurat, kërkesat dhe kriteret për subvencionimin e OJQ-ve. Neni 6, pika 1 – “Ofruesit e mbështetjes financiare përgatisin pjesën e planit vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të më së largu 30 ditë pas miratimit të buxhetit vjetor dhe i dërgojnë atë zyrës përkatëse për qeverisje të mirë pranë ZKM-së”.

Komuna edhe pse kishte dhënë subvencione gjatë vitit 2021, nuk kishte përgatitur plan vjetor për subvencionimin e OJQ-ve i cili do duhej të dorëzohet pranë Zyrës së Kryeministrit.

Kjo kishte ndodhur pasi që Zyrtari Kryesor Administrativ nuk kishte deleguar përgjegjësi për hartimin e planit për financim të OJQ-ve tek përgjegjësit e programeve që bëjnë shpërndarje të subvencioneve.

**Ndikimi** Mungesa e planit vjetor të subvencioneve pamundëson informimin me kohë të palëve të interesuara rreth programit vjetor dhe objektivave që synohen të arrihen përmes financimit të projekteve.

**Rekomandimi A5** Kryetari duhet të sigurojë përmbushjen e kërkesave ligjore në përgatitjen e planit vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të, dhe raportimin e planit në Zyrën e Kryeministrit.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja A6 - Pagesa të projekteve nga buxheti i projekteve tjera**

**Gjetja** Sipas neni 17 pikës 10 të Ligjit Nr. 07/I-041 Ndarjet buxhetore për vitin 2021, ndryshimet në shumat e ndara buxhetore për projektet ekzistuese apo zëvendësimin e projekteve kapitale të komunave, të prezantuara në tabelën 4.2, duke përfshirë edhe të hyrat vetanake të bartura, si dhe të regjistruara në SIMFK, duhet të aprovohen paraprakisht nga Kuvendi Komunal. Rialokimet duhet të kryhen në përputhje me procedurat dhe

kriteret e parapara me udhëzimin administrativ MF. Nr. 05/2019 për procedurat e transferit dhe rialokimit të ndarjeve buxhetore.

Ne tetë (8)<sup>8</sup> pagesa të testuara në vlerë 390,696€, kemi identifikuar se komuna ka përdorë fondet nga projektet për qëllime tjera nga ajo për të cilin ishin planifikuar. Në këto raste, nuk ka aprovim nga Kuvendi Komunal për ri destinim të mjeteve dhe rialokimit të ndarjeve buxhetore nga një projekt kapital në një tjetër.

Zyrtarët nuk kanë ofruar ndonjë shpjegim për mos zbatim të kërkesës ligjore. Megjithëse, kjo situatë është përsëritur, veprimet e tilla janë të ndikuara nga planifikimi jo i mirë i projekteve dhe nga nevojat për mjete buxhetore.

#### **Ndikimi**

Përdorimi i fondeve për qëllime tjera nga ajo për të cilin ishin buxhetuar pa një aprovim paraprak nga kuvendi komunal dhe ministri i financave, përveç që është në kundërshtim me ligjin e buxhetit ndikon që të devijohen projektet nga ato të aprovuara në kuvendin komunal, në të cilin janë diskutuar dhe aprovuar prioritetet e qytetarëve.

#### **Rekomandimi A6**

Kryetari duhet të sigurojë se janë marrë veprimet e nevojshme që projektet e aprovuara të realizohen sipas planifikimit. Nëse paraqitet nevoja për ridestinim të fondeve të projekteve, kjo të realizohet përmes procedurave të përcaktuara me rialokim në pajtim me Ligjin mbi ndarjet buxhetore.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B3 - Dobësitë në menaxhimin e obligimeve dhe shpenzimet shtesë përmbartimore**

#### **Gjetja**

Rregullorja MF Nr. 01/2017 për raportim financiar nga organizatat, neni 17, pika 3, parasheh se organizatat buxhetore raportojnë të gjitha detyrimet (faturat) të krijuara deri me 31 dhjetor të vitit raportues. Ndërsa sipas nenit 39.1 të ligjit Nr. 03/L-048 për MFPP: Çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës. Ne kemi identifikuar se:

Në një rast, obligimi për furnizim me inventar prej 7,227€ nuk ishte paraqitur në regjistrin e obligimeve të papaguara, pra kemi nënvlerësim të obligimeve për këtë vlerë.

Në gjashtë (6)<sup>9</sup> raste faturat në vlerë prej 1,190,047€ nuk janë paguar në afatin e paraparë ligjor. Vonesat ishin rreth 3 muaj.

Po ashtu, Thesari sipas vendimeve gjyqësore/përmbartimore kishte ekzekutuar pagesa nga buxheti i komunës për vitin 2021 në vlerë prej 6,910,470€. Prej tyre 6,360,388€ ishte borxhi kryesor i papaguar i komunës kurse 550,082€ ishin shpenzimet shtesë në emër të procedurës kontestimore /përmbartimore apo interesit.

Shkaku i gabimeve/mos raportimeve të plota në PFV ka ardhur si pasojë e pakujdesisë së zyrtarëve përgjegjës. Kjo kishte ndodhur për shkak hyrjes në obligime financiare pa pasur mjete buxhetore të planifikuara dhe mangësive në menaxhimin e obligimeve.

**Ndikimi** Raportimi i mangët i obligimeve dëmton saktësinë e pasqyrave financiare dhe pamundëson planifikimin afatshkurtër të obligimeve. Vonesat në realizimin e pagesave brenda afatit kohor, ka ndikuar që Komuna të jetë subjekt i padive nga operatorët ekonomik, duke shkaktuar shpenzime shtesë gjyqësore/ përmbare për Komunën.

**Rekomandimi B3** Kryetari duhet të sigurojë se obligimet e mbetura në fund vit të raportohen saktë në Pasqyrat Financiare Vjetore dhe të gjitha informatat për faturat e papaguara dorëzohen me kohë tek Zyrtari Kryesor Financiar. Po ashtu, të sigurohet që të gjitha faturat dhe detyrimet financiare paguhen brenda afatit ligjor dhe punët apo furnizimet të bëhen vetëm atëherë kur komuna paraprakisht i siguron fondet apo ndan mjetet buxhetore të mjaftueshme për pagesë.

### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### **Çështja B4 - Mangësi në përmbushjen e kërkesave ligjore nga tatimi në pronë**

**Gjetja** Sipas nenit 15 të Ligjit Nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, Komuna çdo vit duhet të kryejë veprime të inspektimit (verifikimit) për të paktën 20%, e të gjitha pronave brenda territorit të Komunës. Poashtu sipas të njëjtit ligj nenit 31, pika 6, komuna merr vendim në lidhje me ankesën e dorëzuar brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga pranimi i ankesës. Komuna mund të zgjasë deri në tridhjetë (30) ditë kalendarike, afatin për shqyrtimin e ankesës së dorëzuar, me një vendim të arsyetuar.

- Komuna e Ferizajt kishte faturuar Tatimin në Pronë nga sistemi i Protax për 72,830 objekte. Komuna në vitin 2021 kishte arritur të bëjë inspektimin (verifikimin) e vetëm 1,959 objekteve apo rreth 2.65%; dhe
- Në vitin 2021 komuna kishte pranuar 648 ankesa për tatimin në pronë që kanë të bëjnë me: ankesa për fatura, ankesa për certifikata, dhe kërkesa për korrigjim të bazës tatimore, ndërsa nuk ishin respektuar afatet ligjore për shqyrtimin e tyre ku vonesat ishin nga 3 deri në 6 muaj.

Verifikimi jo i plotë i pronave dhe trajtimi me vonesë i ankesave sipas komunës kishin ndodhur për shkak të stafit të pamjaftueshëm, por edhe për shkak të ndikimit të pandemisë Covid-19. Megjithatë, krahasuar me vitin paraprak 2020, kur masat për pandemin ishin më rigorozë përqindja e inspektimeve në 2021 është edhe më e ulët.

**Ndikimi** Inspektimi i ulët i pronave, mund të rezultojë me informata jo të plota të pronës së tatueshme aktuale si dhe të ndikoj në vlerësim jo të saktë të të hyrave për tatimin në pronë. Më tutje, vonesat në trajtimin e ankesave ndikojnë në mos azhurnimin e informatave në kohë për vlerësimin e duhur të tatimi në pronë si dhe ulin besueshmerinë e qytetarëve në shërbimet e komunës.

**Rekomandimi B4** Kryetari duhet të sigurojë rritjen e aktiviteteve për verifikim të pronave të paluajtshme, sipas kërkesave ligjore, në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor. Po ashtu të shtojë kontrollet që ankesat të shqyrtohen brenda afateve kohore ligjore.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)****Çështja B5 - Angazhimi për shërbime të veçanta pa kryer procedurat të veçanta ligjore**

**Gjetja** Neni 84 i Ligjit për Zyrtarët Publik Nr. 06/L-114, përcakton se, “Marrëveshjet për shërbime të veçanta, sipas paragrafit 4 të nenit 12 të Ligjit të Shërbimit Civil nr. 03/L-149 të Republikës së Kosovës, të lidhura para hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë të vlefshme deri në afatin e përcaktuar në ato marrëveshje në pajtim me dispozitat e lartcekura. Pas kësaj periudhe, marrëveshjet për shërbimet e veçanta lidhen sipas legjislacionit përkatës të prokurimit publik”.

Komuna gjatë vitit 2021 kishte angazhuar 41 zyrtarë për shërbime të veçanta. Këta zyrtarë ishin angazhuar për pozitat si zyrtar për tatim në pronë, zyrtar i pasurisë, zyrtar zotues, zyrtar i personelit. Të gjithë punëtorët e angazhuar, janë kontraktuar pa udhëhequr procedurë të prokurimit.

Sipas menaxhmentit, arsyeja përse nuk kanë mundur me zhvilluar procedura të prokurimit ishte mungesa e planifikimit të buxhetit.

**Ndikimi** Moszbatimi i kritereve të përcaktuara ligjore për angazhimin e personave me marrëveshje për shërbime të veçanta, ka cenuar parimin e konkurrencës, transparencës si dhe ka ndikuar në diskriminimin e të tjerëve, dhe njëherësh rritë rrezikun e angazhimit të stafit jo kompetent për pozita të caktuara.

**Rekomandimi B5** Kryetari duhet të sigurojë se janë ndjekur të gjitha procedurat dhe hapat e prokurimit në angazhimin e kontraktorëve individual për shërbime të veçanta duke u kujdesur që personeli i angazhuar do të jetë për pozita jo të rregullta.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)****Çështja B6 - Mos hartimi i planeve për menaxhimin e kontratave**

**Gjetja** Sipas nenit 61.6 të Rregullore për Udhëzuesin Operativ të Prokurimit Publik, pas pranimit të njoftimit për emërim si menaxher i kontratës, menaxheri i kontratës duhet të kyçet në sistem të prokurimit elektronik dhe duhet të filloj me fazat e menaxhimit të kontratës. Si fazë e parë menaxheri i kontratës duhet të përgatis dhe krijojë një plan për menaxhimin e kontratës.

Në nëntë (9)<sup>10</sup> raste kemi vërejtur që, menaxherët e kontratave nuk kishin përgatitur planin për menaxhimin e kontratës siç kërkohet me Rregullën për udhëzuesin operativ të prokurimit publik.

Kjo ka ndodhur si pasojë se zyrtarët përkatës nuk ishin në dijeni për hartimin i një plani të tillë apo nuk kanë njohuri se si duhet të përgatitet plani.

**Ndikimi** Mungesa e planit për menaxhimin e kontratave, rritë rrezikun e mos përmbushjes së kontratës në përputhje me termat e specifikuar në kontratë.

**Rekomandimi B6** Kryetari duhet të ndërmarr veprimet e nevojshme që menaxherët e kontratave kanë hartuar planet për menaxhimin e kontratave para fillimit të zbatimit të tyre, në mënyrë që kontratat të monitorohen në baza të rregullta.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja B7 - Lista jo e plotë e pagave**

**Gjetja** Rregulla financiare e MF-së Nr. 01-2013, neni 33 parasheh që Organizata Buxhetore duhet të siguroj që të gjithë personat në marrëdhënie pune të paguhen përmes listës së pagave.  
Po ashtu edhe Ligji Nr. 07/L-041 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e RKS për vitin 2021, neni 13.1 përcakton: Asnjë organizatë buxhetore nuk mund të tejkaloj numrin e të punësuarve në nivel të nën-programit, në asnjë kohë gjatë viti fiskal 2021, siç specifikohet në tabelën 3.1, 3.1A dhe 4.1 të bashkangjitura në këtë ligj, përveç lehonive në sistemin shkollor para universitar.

Komuna gjatë vitit 2021 (në fund të vitit) nuk kishte arritur që në listën e pagave të regjistrojë edhe 22 të punësuar, derisa në vitin 2020 kishte 28 të punësuar jashtë listës së pagave. Ndonëse të gjithë këta të punësuar kishin kontrata të rregullta të punës. Mësimdhënësit e angazhuar jashtë listës së pagave, nuk ishin kompensuar dhe komunës i kishin mbetur si obligime të pagave të papaguara 21,060€. Këta punëtorë nuk ishin shpalosur në PFV si të punësuar jashtë listës së pagave.

Kjo ka ndodhur për shkak se në arsim është shtuar numri i paraleleve më shumë se sa ishin në planin për regjistrimin e nxënësve në klasat e 10-ta për vitin shkollor 2021/2022, mungesa me arsye të mësimdhënësve dhe pushimet e lehonisë.

**Ndikimi** Mos përfshirja e punëtorëve në listën e pagave, ndikon në rritjen e obligimeve të papaguara dhe vonesat e pagesave rrisin rrezikun e shpenzimeve shtesë përmes procedurave gjyqësore/ përmbarimore.

**Rekomandimi B7** Kryetari duhet të që para shtimit të numrit të paraleleve të sigurohet se ka në dispozicion buxhet të mjaftueshëm për çdo pozitë për rekrutim dhe ka vende të lira për përfshirjen e tyre në listën e pagave.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**



## 2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.3.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga komuna në vitin 2021 ishin në vlerë 5,188,599€ dhe kanë pasur një rritje prej 2,107,103€ në krahasim me vitin 2020, ku të hyrat ishin 3,081,495€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Përveç të hyrave direkte, komuna kishte realizuar edhe të hyra indirekte nga gjobat në trafik në vlerë prej 928,860€, gjobat e gjykatave 62,495€ dhe të hyrat nga agjencia e pyjeve 15,400€.

#### Çështja A7 - Mos-raportimi i të hyrave të arkëtuara

##### Gjetja

Ligji Nr. 03/L-048 Për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi, neni 16, Pranimi i parave publike 16.1 Asnjë autoritet publik, person ose ndërmarrje nuk do të pranojë para publike, përveç nëse autorizohet shprehimisht në bazë të një ligji ose rregullore ose me shkrim nga Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit. Neni 16.2 Të gjitha të ardhurat e një autoriteti publik ose ndërmarrje të kontrolluar publike depozitohen në një llogari zyrtare bankare në pajtim me aktet nënligjore.

Teatri i Qytetit “Adriana Abdullahu” mbikëqyret nga drejtorja për kulturë dhe sport në komunë, i cili mbledh dhe shpenzon të hyra me para në dorë, por nuk i raporton dhe nuk i dorëzon në Llogarinë e Vetme të Thesarit (LIVTh). Teatri, gjatë vitit 2021 ka inkasuar të hyra nga shitja në vlerë 3,120€, të cilat nuk i ka dorëzuar dhe raportuar në LIVTh.

Drejtorja e komunës për kulturë dhe sport, nuk e ka menaxhuar këtë situatë, prandaj, rrjedhimisht edhe funksionimi i kontrolleve në këtë aktivitet nuk ka funksionuar.

##### Ndikimi

Mos raportimi i të hyrave tek njësia e të hyrave në komunë, shpie në mosdeklarim të të hyrave dhe rrjedhimisht mund të rris rrezikun që paratë publike të keqpërdoren. Kryerja e aktiviteteve të mësipërme është jashtë kornizës ligjore mbi arkëtimin dhe shpenzimin e parasë publike dhe nuk mundëson kontrolle adekuate ndaj këtyre burimeve.

##### Rekomandimi A7

Kryetari duhet të ndërmarrë veprimet e duhura për të vendosur kontrollet e brendshme në mënyrë që të gjitha të hyrat e mbledhura dhe shpenzimi i këtyre mjeteve duhet të bëhet në përputhje me rregullat dhe sipas kërkesave ligjore. Si dhe të sigurojë mundësin e një rishikim të kontrollit për tri vitet paraprake nga njësia e auditimit të brendshëm.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.3.2 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime si dhe shërbimet komunale ishte 5,835,483€, prej tyre ishin shpenzuar 5,797,134€ ose 99%. Ato kanë të bëjnë kryesisht me furnizime për zyrë, derivate dhe lëndë tjera për ngrohje, komunal, mirëmbajtje të objekteve dhe shpenzime kontraktuese tjera, etj.

### Çështja A8 - Humbjet financiare nga ndërprerja e kontratës

**Gjetja** Sipas neni 829.3 të ligjit për marrëdhëniet detyrimore 04-L-077, përfaqësuesit tregtar i cili për shkak të denoncimit të pabazuar e ka ndërprerë veprimtarinë e vet, ka të drejtë në shpërblimin e dëmit për shkak të provizionit të humbur, e në qoftë se ai e ka denoncuar kontratën në mënyrë të pabazuar e drejta e shpërblimit të dëmit i takon urdhërdhënësit.

Nga testimi i pagesës prej 106,183€ për Mirëmbajtjen e ngrohjes qendrore për ndërtesën e administratës komunale dhe institucioneve të tjera në kuadër të komunës së Ferizajt, më datë 25.09.2014, komuna kishte lidhur kontratë publike kornizë me OE me vlerë të parashikuar prej 117,007€. Mirëpo, me datën 17.12.2014, komuna e kishte ndërprerë kontratën në mënyrë të njëanshme me pretendimin se OE nuk ka bërë realizimin e kontratës. Sipas vendimit të gjykatës së apelit, komuna në mënyrë të njëanshme ka bërë ndërprerjen e kontratës pa i zbatuar të gjitha procedurat e përcaktuara për ndërprerje të kontratës dhe jo për arsye se OE nuk i ka kryer punët sipas kontratës. Si pasojë, komuna obligohet që ti paguaj OE dëmin e shkaktuar, fitimin e humbur dhe interesit në vlerë prej 106,183€.

Shkaku përse ka ardhur deri tek kjo, nga zyrtarët nuk kemi pranuar ndonjë shpjegim për mos zbatim të kërkesës ligjore, nuk është ofruar ndonjë argument se komuna i ka ndjekur hapat ligjorë për ta shkëputur këtë kontratë.

**Ndikimi** Si pasojë e ndërprerjes së njëanshme të kontratës, dhe menaxhimit jo adekuat të kontestit gjyqësor nga komuna, ka rezultuar me humbje të parasë publike dhe implikime buxhetore ndaj projekteve tjera dhe shpenzimeve operative të komunës.

**Rekomandimi A8** Kryetari duhet të siguroj menaxhim më të mirë të kontratave publike duke bërë zbatimin e përpiktë të të gjitha pikave të kontratës dhe në raste kur paraqiten rrethana ku OE nuk bëjnë zbatimin e tërësishëm të kontratave të ndërmerren të gjitha veprimet e nevojshme para se të kërkohet shkëputja e kontratës.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### Çështja A9 - Anashkalimi i procedurave të prokurimit

**Gjetja** Sipas Rregullës financiare Nr.01/2013 shpenzimet për të cilat nuk ka nevojë të zhvillohen procedura të prokurimit janë: pagat, shpenzimet e paguara me para të imët, avancat për udhëtime zyrtare, shërbimet komunale, subvencionet dhe transferet, dhe transaksionet ndër departamentale”.

Tek pagesa me vlerë 7,227€, për furnizime me mobile për zyre, komuna nuk kishte zhvilluar procedurë të prokurimit, fatura për këtë furnizim nuk ishte e

regjistruar në regjistrin e protokollit sipas procedurës ligjore, dhe në fund, kjo ka rezultuar që pagesa për këtë furnizim të bëhet nga thesari sipas vendimit të përmbartimit.

Shkaku për këtë është mungesa e funksionimit të kontrolleve të brendshme.

**Ndikimi**

Mos aplikimi i procedurave të prokurimit ndikon në zvogëlimin e transparencës për shpenzimin e parasë publike, si dhe kjo rritë rrezikun që komuna mos merr shërbimin apo produktet për paratë e shpenzuara.

**Rekomandimi A9** Kryetari duhet të sigurohet se blerja e shërbimeve apo produkteve të bëhet sipas procedurave adekuate të prokurimit publik duke respektuar procesin e blerjes prej inicimit të kërkesës deri tek nënshkrimi i kontratës.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 2.3.3 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 11,872,181€, prej tyre ishin shpenzuar 10,772,882€ apo rreth 91% të buxhetit final. Shpenzimet për investime kapitale kanë të bëjnë me asfaltimin e rrugëve lokale, kanalizime, shpronësime, objekte arsimore e shëndetësore.

#### Çështja A10 - Specifikimi teknik jo i qartë/matshëm

##### Gjetja

Sipas nenit 28.4 të LPP-së, autoritetet kontraktuese do të formulojnë specifikimet teknike duke iu referuar (i) një standardi të Kosovës që implementon një standard Evropian, (ii) një standardi Evropian, (iii) një miratimi teknik Evropian, (iv) një specifikimi të përbashkët teknik, (v) një standardi ndërkombëtar apo (vi) çfarëdo referimi tjetër teknik të nxjerrë nga organet Evropiane për standardizim, gjithashtu neni 28.8 "Kërkesat ekzekutuese dhe funksionale duhet të jenë të sakta në mënyrë që të iu mundësoj tenderuesve që të përcaktojnë lëndën kryesore të kontratës dhe t'i lejoj autoritetet kontraktuese që të shpërblejnë kontratën. Dhe sipas 28.7 Autoriteti kontraktues nuk do të përpilojë specifikimet teknike që i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë ose ndonjë prodhimi.

Në tri raste gjatë shqyrtimit të specifikave janë identifikuar këto mangësi:

- Për ndërtimin e tregut të kafshëve, komuna kishte lidhur kontratë me vlerë prej 218,272€, në formulimin e specifikave teknike ishin bërë përkrahje jo të sakta dhe jo të matshëm të pozicioneve si: nuk ka përcaktuar standardin e cilësisë së punimeve apo produkteve të kërkuara, duke kërkuar vetëm Beton; Tek pjesa N e paramasës, pozicioni nr. 5 është kërkuar "Furnizimi dhe montimi i kanalit të mbledhjes së fekaleve të mbuluar me reshetke metalike duke e llogaritur edhe gypin e PVC i cili bën bartjen si dhe ndërtimin e gjashtë pusetave mbledhëse" duke ditur që "kanali është punë për të cilin nuk iu kanë përcaktuar dimensionet, dhe për më tepër gypit nga PVC nuk iu është përcaktuar diametri. Gjithashtu, në specifikacion teknik është përdorur edhe emri tregtar për llamarinën e plastifikuar.
- Për kontratën Ndërtimi i shkollës Konstandin Kristoforidhi në fshatin Nerodime, në vlerë prej 332,525€, janë vërejtur gabime në formulimin e specifikave teknike, në të cilën nuk është përcaktuar standardi i betonit, si dhe numri i dhomave termike për profilet e dritareve. Po ashtu, në specifikacion teknik janë përdorur emra tregtar për llamarinën të plastifikuar dhe për profile të dyerve dhe dritareve.
- Te kontrata Asfaltimit rrugës kryesore në fshatin Cernill, Komuna kishte lidhur kontratë me vlerë prej 499,900€, në formulimin e specifikave teknike, komuna ka përdorur marka specifike tregtare për gjeotekstil dhe nuk ka përcaktuar standardin e cilësisë së asfaltit dhe ngjeshjet së tamponit dhe asfaltit.

Lidhur me specifikimin teknik jo të qartë/matshëm, ka ndodhur për shkak se njësitë kërkuuese nuk kanë bërë rishikim adekuat dhe në mënyrë profesionale për të eliminuar paqartësitë dhe zyrtari përgjegjës i prokurimit nuk ka ushtruar kontrolle të mjaftueshme për të parandaluar këtë mangësi.

##### Ndikimi

Mos përcaktimi i saktë i standardit të kualitetit të punimeve apo produkteve të kërkuara ndikon që mbikëqyrja e kontratave të mos jetë efikase dhe

punimet të kryhen me kualitet të dobët. Kjo bënë që operatorët ekonomik të jenë të keq orientuar dhe mund të ndikoj në ofertën financiare dhe çmimin e kontratës.

**Rekomandimi A10** Kryetari duhet të sigurojë se funksionon kontrolli i duhur përmes zyrës së prokurimit, ashtu që, të rishikoj se njësitë kërkuese bëjnë hartimin e specifikimeve teknike sipas kërkesave ligjore dhe nevojave të komunës duke përcaktuar standardin e cilësisë së punës apo furnizimit.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja A11 - Mungesa e projektit ekzekutues**

**Gjetja** Sipas Nenit 28, pika 10 të ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, përcakton “Për përgatitjen e specifikimeve teknike për kontratat për punë”, autoriteti kontraktues është përgjegjës për hartimin e projektit dhe nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkangjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit.

Komuna ka filluar procedura të prokurimit dhe kishte lidhur kontratë për Ndërtimin e tregut të kafshëve 218,272€ pa hartuar paraprakisht projektin ekzekutiv të ndërtimit.

Zhvillimin e procedurave të prokurimit në mungese të projektit ekzekutues, kjo ka ndodhur për shkak të neglizhencës së njërive kërkuese pa bërë paraprakisht hartimin e projekteve ekzekutive zbatuese dhe mos funksionimit efikas të kontrolleve tek zyra e prokurimit duke zhvilluar procedurat pa u përmbushur kërkesat ligjore.

**Ndikimi** Inicimi i procedurës së prokurimit në mungesë të projektit ekzekutiv, mund të ndikoj me realizim të dobët të kontratave për punë si dhe mund të afektojë shpenzim të paparashikuar apo vlerë të dobët për paranë e shpenzuar.

**Rekomandimi A11** Kryetari të siguroj kontrolle dhe monitoroj zbatimin e kërkesave ligjore, që me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit për kontraktimin e punëve/ndërtimit të sigurohet paraprakisht hartimi i projekteve në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja A12 - Vonesa në realizimin e kontratës**

**Gjetja** Sipas nenit 10.2 të kushteve të veçanta të kontratës përfundimi i të gjitha punëve do të duhej të kryheshin brenda tri (3) viteve.

Te kontrata “Ndërtimi i shkollës së mesme në komunën e Ferizajt” në vlerë 1,803,726€ e nënshkruar më 20.01.2017, kishte vonesa në përfundimin e projektit, punimet duhej të përfundonin me 20.11.2020 sipas kontratës bazë. Mirëpo deri në shkurt të vitit 2022 punimet nuk ishin përfunduar, kontrata ishte realizuar 57%, derisa pagesat ishin bërë në vlerë 1,031,555€.

Sipas komunës vonesat kishin ndodhur pasi që ishte bërë ndërrimi i vendit të lokacionit për ndërtimin e shkollës dhe sigurimi i vendimit për leje

ndërtimore kishte shkaktuar vonesë për fillimin e punimeve.

**Ndikimi** Mos përmbushja e kontratës sipas kushteve të specifikuara në kontratë, tregon se planifikimi dhe përgatitjet e kontratave kanë dobësi të theksuara, duke ndikuar që punët të vonohen dhe mos realizohen siç ishin me kontratë. Problemet e tilla mund të sjellin edhe vështirësi financiare.

**Rekomandimi A12** Kryetari duhet të sigurojë se janë eliminuar të gjitha pengesat që e pamundësojnë realizimin e kontratës sipas kushteve të kontratës para inicimit të procedurave të prokurimit dhe hyrjes në obligime kontraktuale ashtu që realizimi i kontratës të mos ketë pengesa.

### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### **Çështja B8 - Ndryshimi i kontratave të prokurimit pa aprovimet e duhura**

**Gjetja** Sipas nenit 61.23 të rregullave të UOPP-së “Ndryshimi i kontratës nuk do t’i lëshohet OE para marrjes së aprovimit nga ZKA”. Ndërsa sipas nenit 61.19 Përgjegjësi e menaxherit të projektit është të menaxhoj obligimet dhe detyrat e AK-së të specifikuara në kontratë dhe të sigurojë se operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë. Dhe nenit 61.25 të rregullave të UOPP-së, asnjë ndryshim kontrate nuk do ta shtojë çmimin total të kontratës me më shumë se 10% të çmimit fillestar të kontratës. Ne identifikuam mangësi në menaxhimin e kontratave si në vijim:

Kontrata për rregullimin e kanalizimit në fshatin Kosinë në vlerë 213,953€, përbëhet prej dy segmenteve dhe ndërtimin e rezervuarit për pompim. Mirëpo gjatë realizimit, komuna kishte bërë ndryshime të kontratës prej më shumë se 10% (29,851€) që lejon LPP. Njëri segment nuk ishte realizuar fare për shkak se me rastin e planifikimit të projektit, nuk ishin marrë parasysh të gjithë faktorët për realizimin e këtij projekti si, kalimi i gypave nëpër prona private dhe nevojave tjera reale për këtë projekt.

Te kontrata “Asfaltimi i rrugës në Zaskok” në vlerë 369,186€, ishin bërë ndryshim të sasive nëpër pozicione por pa ndikim në çmimin total të kontratës. Aprovimet për këto ndryshime nuk ishin marr nga ZKA, por vetëm nga menaxheri i projektit. Kjo kishte ndodhur për shkak se me rastin e planifikimit të projektit nuk ishin marrë parasysh nevojat reale për këtë projekt.

Kjo ka ndodhur si pasojë e mungesës së kontrollit në zbatimin e kushteve të përcaktuara me kontratë.

**Ndikimi** Mungesa e aprovimeve paraprake për ndryshime, dhe mos përmbushja e kontratës sipas kushteve të specifikuara në kontratë, tregon se planifikimi dhe përgatitjet e kontratave kanë dobësi të theksuara që ndikon në rritjen e obligimeve të paplanifikuara.

**Rekomandimi B8** Kryetari duhet të siguroj që menaxheri i kontratës të veprojë në bazë të përgjegjësisë, me qëllim të respektimit të rregullave dhe mos tejkalimit të kompetencave, dhe sa herë që paraqitet nevoja për ndryshime të kontratës, të bëjë kërkesë për aprovim të ndryshimeve duke arsyetuar kërkesën për ndryshim. Po ashtu, të mos bëjë autorizimin e ndryshimeve të

projektit më shumë se 10% që lejohet me ligj.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 2.3.4 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 214,924,427€, pasurive jokapitale është 0€ (zero), si dhe e stokeve 27,464€.

#### Çështja A13 - Mangësi në inventarizimin e pasurisë

##### Gjetja

Sipas neni 19.4.3 të rregullores Nr. 02/2013 – për Menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, Komisioni për Inventarizimin e Pasurive jo Financiare është përgjegjës për krahasimin e gjendjes të inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare dhe identifikimin e pasurisë që nuk ka vlerë të bartur. Po ashtu, sipas nenit 4.1 Zyrtares Kryesor Administrativ është përgjegjës për aprovimin e rregullave dhe procedurave të brendshme për evidencën.

Komuna e kishte kryer inventarizimin e pasurisë, mirëpo nuk kishte bërë harmonizimin / krahasimin nga gjendja e inventarizimit me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare.

Komuna nuk ka aprovuar rregulla dhe procedura të brendshme për ndarje të drejt të detyrave për regjistrimin dhe raportimin e pasurive, evidencën dhe ruajtjen e pasurive, ngarkimin e pasurive tek personat përgjegjës që do të kujdeseshin për pasuritë e ngarkuara apo edhe procedurën e inventarizimit dhe krahasimit.

Kjo ka ndodhur për shkak të mos funksionimit adekuat të kontrolleve të brendshme të komunës sa i përket fushës së pasurisë.

##### Ndikimi

Mungesa e rregullave të brendshme dhe mos krahasimi i raporteve të inventarizimit me regjistrat e pasurisë ka vështirësuar menaxhimin efektiv të pasurisë dhe për rrjedhojë vlera e paraqitur në PFV është e pa saktë, pra nuk është prezantuar gjendja reale e pasurisë me të cilat disponon komuna.

##### Rekomandimi A13

Kryetari duhet të sigurohet se bëhet krahasimi i raporteve të inventarizimit me regjistrat e pasurisë si dhe azhurnohen regjistrat e pasurisë sipas të dhënave të regjistrimeve të fundit. Kryetari duhet të analizoj nëse është e nevojshme hartimi i procedurave dhe rregulloreve të brendshme për menaxhimin e pasurisë së komunës.

##### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)



### 2.3.5 Të arkëtueshmet

Komuna në PFV-të e vitit 2021 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 14,144,460€. Kjo vlerë përbehet nga tatimi në pronë 11,289,642€, leje ndërtimore 1,971,665€, taksa e bizneseve 763,281€, qiraja 116,887€ dhe çerdhja 2,985€.

#### Çështja B9 - Rritja e Llogarive të Arkëtueshme

##### Gjetja

Sipas nenin 26 të ligjit për tatimin në pronën e paluajshme Nr. 06/L 005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbarese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) Eurove dhe neni 27 Nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori.

Sipas nenit 14 të Rregullores Nr. 01/186 - për taksa tarifa dhe gjoba komunale, përcaktohet që për mospagimin e taksave dhe ngarkesa të përcaktuara në rregullore, në afatin të cilin e përcakton organi zyrtar përkatës, për të cilat ka faturë iniciohet procedura përmbare.

Komuna nuk kishte menaxhim efektiv në mbledhjen e LI.A, pasi që vazhdon rritja e tyre nëpër vite. Sipas pasqyrave vjetore financiare të vitin 2021, në raport me vitin paraprak, ato janë rritur për 2,244,828€. Komuna nuk kishte ndërmarrë ndonjë veprim konkret për mbledhjen/realizimin e LI.A.

Rritja më e madhe ishte te tatimi në pronë i cili ishte i ndikuar edhe nga borxhet e ndërmarrjeve shoqërore të menaxhuara/privatizuara nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP). Këto borxhe (të akumuluar ndër vite) janë mbi 1,600,000€. Problemet në inkasimin/rritjen e këtyre borxheve paraqiten pasi që pronat e AKP-së sipas evidencës në total ishin 144, përderisa 104 prej tyre nuk ishin aktive por që borxhi është evident.

Megjithëse edhe vitet paraprake nuk ishte gjendja e mirë e menaxhimit të LI.A, në këtë vit ka ndikuar edhe gjendja e krijuar me Covid-19.

##### Ndikimi

Rritja e LLA nëpër vite, dhe mos marrja e veprimeve për inkasim të tyre, ndikon në përkeqësimin e performancës së inkasimit të këtyre llogarive dhe nga ana tjetër ndikohet trendi negativ i rritjes vit pas viti duke rrezikuar arkëtimin e tyre, si dhe reflekton negativisht në financimin dhe realizimin e projekteve nga të hyrat vetanake.

##### Rekomandimi B9

Kryetari duhet të siguroj procedura të qarta për inkasimin e llogarive të arkëtueshme, gjithashtu duhet të siguroj veprime adekuate për një zgjidhje të përbashkët me Agjensin Kosovare të Privatizimit lidhur me obligimet për ndërmarrjet shoqërore të cilat janë në menaxhimin e tyre dhe që çështja e pagesës së borxheve të vjetra të ish-ndërmarrjeve shoqërore të gjejë një formë të përshtatshme të realizimit të tyre. Po ashtu Kryetari, duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme,

duke vendosur politika dhe rregullore me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e borxheve duke shqyrtuar gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj operatorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 2.3.6 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Njësia e auditimit të brendshëm (NjAB) operon me tre anëtarë të stafit-drejtori i NJAB-së dhe dy auditor. NjAB për vitin 2021 kishte planifikuar shtatë auditime të cilat deri në fund të vitit i kishte finalizuar për fushat: mallra shërbime, subvencione, investime kapitale, menaxhimi i resurseve, menaxhim i inventarit, zyra e prokurimit dhe të hyra. Nga këto auditime kanë rezultuar 21 rekomandime ku tri (3) rekomandime ishin zbatuara, 13 ishin në proces dhe pesë (5) rekomandime nuk ishin zbatuara ende. Komuna kishte të themeluar komitetin e Auditimit të brendshëm.

#### Çështja B10 - Mos funksionimi i Komitetit të Auditimit

**Gjetja** Neni 8 i UA MF- Nr. 01/2019 për themelimin dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit (KA) në subjektin e sektorit publik parasheh që KA duhet të mbajë së paku katër mbledhje brenda vitit kalendarik, për të shqyrtuar rekomandimet nga raportet e Auditimit të Brendshëm dhe Auditimit të Jashtëm.

Për vitin 2021, KA nuk kishte mbajtur asnjë takim/mbledhje duke pamundësuar ndihmën për ZKA në përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, shqyrtimin e raporteve dhe dhënien e mbështetjes së NjAB-së.

Shkaqet e mos funksionimit të KA, nuk janë sqaruar nga ana e zyrtarëve komunal. Megjithatë, vërehet se komuna nuk i ka kushtuar vëmendje kësaj situate.

**Ndikimi** Mos funksionimi i komitetit të auditimit, ndikon negativisht në efektivitetin e kontrolleve të brendshme të komunës dhe funksionimin e auditimit të brendshëm.

**Rekomandimi B10** Kryetari duhet të sigurojë funksionimin e komitetit të auditimit që të rishikojë në mënyrë kritike planet e auditimit të brendshëm për të konfirmuar se ato bazohen në rrezik dhe t'i ofrojë sigurinë e kërkuar menaxhmentit. Gjithashtu, Komiteti duhet të monitoroj veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e auditimit.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Ne kemi marrë parasysh burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të ardhurave të mbledhura nga kategoritë ekonomike. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final <sup>11</sup>	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
<b>Burimet e fondeve</b>	<b>34,208,507</b>	<b>36,749,213</b>	<b>35,241,146</b>	<b>35,334,404</b>	<b>31,895,782</b>
Grante Qeveritare – Buxheti	27,040,376	28,726,718	28,616,373	28,652,305	25,275,916
Financimi përmes huamarrjes	0	79,646	79,477	174,703	26,496
Financimi përmes huamarrjes – klauzola e investimeve	2,723,503	2,723,503	1,779,340	2,320,660	1,025,000
Të bartura nga viti i kaluar	0	661,269	656,349	1,027,347	801,890
Të hyrat vetanake	4,444,628	4,444,628	4,025,196	3,081,851	4,698,755
Donacionet vendore	0	98,248	79,676	57,891	51,977
Donacionet e jashtme	0	15,201	4,736	19,648	15,749

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 2,540,706€. Kjo rritje është rezultat i rritjes grantit prej 1,686,342€ dhe të financimit nga huamarrja prej 79,646€, rritjes nga të hyrave të bartura nga viti paraprak 661,269€, rritjes së donacioneve të brendshme dhe të jashtme me 113,449€.

Në vitin 2021 komuna e Ferizajt ka shpenzuar 96% të buxhetit përfundimtar ose 35,241,146€ me një përmirësim prej 3% në krahasim me vitin 2020, ku realizimi ishte 93% ose 35,334,404€. Realizimi i buxhetit është në nivel të kënaqshëm dhe shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.


**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b>	<b>34,208,507</b>	<b>36,749,213</b>	<b>35,241,146</b>	<b>35,334,404</b>	<b>31,895,782</b>
Pagat dhe mëditjet	15,805,932	17,570,966	17,568,098	15,865,122	15,310,882
Mallrat dhe shërbimet	5,050,000	5,135,170	5,099,813	6,003,802	4,291,782
Komunalitë	699,680	700,313	699,321	624,686	622,182
Subvencionet dhe transferet	715,500	1,110,364	1,101,033	767,139	562,283
Investimet Kapitale	11,113,382	11,872,181	10,772,882	12,073,655	11,108,654
Rezervat	824,013	360,219	0	0	0

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë: (Përshkrimet të renditen konform radhitjes në tabelën e mësipërme).

- Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,765,035€. Kjo rritje është: 1,695,034€ nga Granti qeveritar, 12,000€ nga Granti donator dhe 58,000€ nga Huamarrja. Ky buxhet është shpenzuar 100%;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime dhe shpenzime komunale në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 85,802€, ndërsa buxheti i realizuar për këtë kategori ishte 99%. Ky ndryshim buxhetor është nga zvogëlimi i grantit qeveritar në shumë 7,867€, dhe rritje nga të hyrat e bartura në shumë 71,268€, donacionet 8,261€ dhe huamarrja në shumë 14,140€;
- Buxheti final për subvencione kishte rritje për 394,864€, kjo rritje ishte nga të hyrat vetanake 390,000€ dhe 4,864€ nga granti donator; dhe
- Buxheti final për investime kapitale në raport me buxhetin fillestar kishte rritje për 758,800€, përkundër kësaj rritje të buxhetit realizimi ishte në nivelin prej 91%. Kjo rritje ishte nga granti 463,794€ të hyrat vetanake 200,000€ dhe 87,865€ nga granti donator dhe nga huamarrja 7,141€. Një pjesë e kësaj rritje të buxhetit është dedikuar për projektet të reja si sera bujqësore e participim për lope me blegtor, mjete konkretizimi, pajisje teknologjisë informative; Mjetet e shpenzuara në vitin 2021 për Rimëkëmbjen Ekonomike ishin 528,033€, ato kryesisht ishin ndarë për shtesa në arsim dhe shëndetësi.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2021



Të hyrat e realizuara nga komuna në vitin 2021 ishin në vlerë 5,188,599€ dhe kanë pasur një rritje prej 2,107,103€ në krahasim me vitin 2020, ku të hyrat ishin 3,081,495€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Përveç të hyrave direkte, komuna kishte realizuar edhe të hyra indirekte nga gjobat në trafik në vlerë prej 928,860€, gjobat e gjykatave 62.500€ dhe të hyrat nga agjencia e pyjeve 15,400€.

Tabela 3. Të hyrat (në €)


Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Pranimet	2020 Pranimet	2019 Pranimet
<b>Totali i të hyrave</b>	<b>4,444,628</b>	<b>4,444,628</b>	<b>5,188,599</b>	<b>3,081,496</b>	<b>4,561,624</b>
Të hyrat tatimore	2,768,575	2,768,575	2,510,636	1,369,174	1,789,999
Të hyrat jo tatimore	1,676,053	1,676,053	2,677,962	1,712,321	2,771,625

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2020 të Komunës së Ferizajt ka rezultuar në 18 rekomandime kryesore. Komuna e Ferizajt kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Komuna nuk kishte mbajtur ndonjë dëgjim publik lidhur me zbatimin e rekomandimeve nga raporti i ZKA.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2021, pesë rekomandime janë zbatuar, dhjetë të pazbatuara dhe tri nuk aplikohen më, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

**Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak**



**Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak**

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha pasuritë e komunës janë regjistruar në regjistra përkatës si dhe shpalosur saktë në PFV. Sistemi e-pasuria duhet të funksionalizohet, për të mundësuar menaxhimin dhe kontrollin më të mirë të pasurive. Po ashtu, komisioni për inventarizim duhet të funksionoj sipas kërkesave për të mundësuar azhurnimin e regjistrave kontabël të pasurive përpara përgatitjes së pasqyrave financiare.	Në mostrat e testuara kemi identifikuar se blerjet e pasurive nuk ishin regjistruar në regjistra dhe E-pasuria nuk ishte funksionale ndërsa raporti për inventarizimin e pasurive ishte jo i plotë.	Nuk ka filluar zbatimin

2.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë funksionimin efikas të kontrolleve financiare për raportimin e saktë të obligimeve dhe kryerjen e pagesave brenda afatit të paraparë ligjorë.	Edhe në këtë vitë kemi vërejtur nënvlerësim të obligimeve të papaguara, mirëpo ky rekomandim trajtohet tek çështja Dobësitë në menaxhimin e obligimeve dhe shpenzimet shpeshë përmbartimore.	Nuk është i aplikueshëm më
3.	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor. Përmirësimi në mbledhjen e të hyrave nga ky burim do të ndikoj drejtpërdrejt në realizimin e projekteve që kanë efekt në rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët e komunës. Po ashtu, personeli i Tatimit në Pronë duhet të shqyrtoj ankesat brenda afatit të përcaktuar.	Edhe këtë vit komuna nuk ka arritur që të bëj verifikimin e 20% pronave.	Nuk ka filluar zbatim
4.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të sigurojë se janë ndjekur të gjitha procedurat dhe hapat e prokurimit në angazhimin e kontraktorëve individual për shërbime të veçanta duke u kujdesur që personeli i angazhuar do të jetë në gjendje të përmbush detyrat e kërkuara. Po ashtu, menaxhmenti duhet të përkujdeset që angazhimet për pozitat e rregullta të zhvillohen përmes procesit të rregullt të rekrutimit	Edhe këtë vit komuna kishte angazhuar punëtor me kontratë për shërbime të veçanta pa zhvilluar procedura të kërkuara.	Nuk ka filluar zbatim
5.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të sigurohet që para shtimit të numrit të paraleleve të sigurohet se ka në dispozicion buxhet të mjaftueshëm për çdo pozitë për rekrutim dhe ka vende të lira për përfshirjen e tyre në listën e pagave. Në PFV duhet të shpalosen informatat e sakta në lidhje me numrin e të gjithë punëtorëve, përfshirë edhe ata jashtë listës së pagave.	Edhe këtë vit komuna kishte punëtor jashtë listës së pagave.	Nuk ka filluar zbatim
6.	Mallrat dhe shërbimet pa Komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë që procesi i vlerësimit të filloj menjëherë pas hapjes së ofertave (brenda afateve ligjore), dhe të obligoj menaxherët e kontratave që planet për menaxhimin e kontratave të jenë hartuar para fillimit të zbatimit të tyre në mënyrë që kontratat të monitorohen në baza të rregullta.	Nga procedurat e shqyrtuara të prokurimit kemi vërejtur se menaxherët e kontratave nuk kishin hartuar planin për menaxhimin e kontratës.	Nuk ka filluar zbatim



7.	Investimet kapitale	Kryetari, duhet të vendos kontrolle shtesë gjatë procedurave të prokurimit për të siguruar se ato zhvillohen në pajtim me kërkesat ligjore dhe ofrojnë vlerë të shtuar për paranë e shpenzuar. Për më tepër, kriteret mbi peshimin e çmimeve sipas rëndësisë së artikujve duhet të jenë vendosur në mënyrë që të ketë bazë përcaktuese në përzgjedhjen e operatorit ekonomik (OE). Po ashtu, para nënshkrimit të kontratave fondet duhet të jenë në dispozicion, dhe regjistrimi i shpenzimeve të jetë nga projekti adekuat.	Ne mostrat e testuara kemi identifikuar se vlerësimi i ofertave për tender ishte sipas procedurave të LPP.	I zbatuar
8.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që me rastin e hartimit të paramasës dhe paralogarisë janë vlerësuar saktë pozicionet që duhet punuar, në mënyrë që ndryshimet gjatë ekzekutimit të projektit të minimizohen. Po ashtu, menaxherët e kontratave duhet të raportojnë çdo largim/shtim nga termat dhe kushtet e kontratës duke arsyetuar me analiza specifike këto ndryshime dhe paraprakisht duhet të marrin aprovimin nga ZKA. Po ashtu, duhet eliminuar të gjitha pengesat që e pamundësojnë realizimin e kontratës sipas kushteve të parapara.	Edhe këtë vit komuna ka lidhur kontrata me paramasa jo sipas nevojave reale duke shkaktuar nevojën për ndryshime të kontratave duke tejkaluar limitet ligjore.	Nuk ka filluar zbatimin
9.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë ndarjen e drejtë të detyrave ndërmjet zyrtarëve të përfshirë në procesin e prokurimit. Menaxheri i prokurimit nuk duhet të përfshihet në pranimin e punëve e as zyrtarët të cilët janë të përfshirë në vlerësimin e tenderëve nuk mund të angazhohen në menaxhim të kontratave.	Me rastin e testimit të procedurave ne nuk kemi vërejtur ndarje jo të drejtë të detyrave.	I zbatuar
10.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë përmes menaxherit të prokurimit që siguria e ekzekutimit është në përputhje me afatet e parapara për përmbushjen e kontratave, në të kundërtën nuk duhet të lidhet kontrata. Pra siguria e ekzekutimit duhet të jetë valide për një periudhë prej tridhjetë ditë pas kompletimit të kontratave	Nga procedurat e testuara ne nuk kemi vërejtur ndonjë rast pa siguri të ekzekutimit.	I zbatuar
11.	Çështjet e përbashkëta	Kryetari duhet sigurojë që obligimet të planifikohen/buxhetohen dhe paguhen brenda afateve ligjore me qëllim që mos të dëmtohet buxheti i komunës me kosto shtesë të përmbarimit.	Nga mostrat e testuar kemi vërejtur se komuna nuk i kishte bërë pagesën e faturave brenda afatit kohor se kishte pagesa përmes procedurave gjyqësore/përmb aruesve.	Nuk ka filluar zbatimin

12.	Çështjet e përbashkëta	Kryetari duhet të sigurojë marrjen e masave të nevojshme për një planifikim të drejtë të sasive indikative të kontratave kornizë në mënyrë që shpenzimi i buxhetit të bëhet në pajtim me tolerancën e lejuar +/- 30%. Tejkallimet e kontratave në këtë formë duhet të ndërprehen nga menaxherët e kontratave si preventiv për përmirësimet në të ardhmen.	Nuk kemi hasur tejkallim të sasive indikative.	I zbatuar
13.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari në bashkëpunim me ZKF-në duhet të siguroj nga drejtoritë përkatëse, evidencë të saktë të LLA duke raportuar në baza të rregullta për gjendjen e tyre. Të përgatit një plan veprimi për arkëtimin e tyre duke ndjekur procedura ligjore, me këshillim nga zyra e avokatit të komunës për veprimet ligjore. Këto llogari të arkëtueshme duhet të përcillen nëpër vite me një kujdes të veçantë.	Komuna nuk ka ndërmarr masa për adresimin e këtij rekomandim.	Nuk ka filluar zbatimin
14.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të siguroj procedura të qarta për inkasimin e LLA, gjithashtu duhet të siguroj veprime adekuate për një zgjidhje të përbashkët me AKP-në lidhur me obligimet për ndërmarrjet shoqërore të cilat janë në menaxhimin e tyre dhe që çështja e pagesës së borxheve të vjetra të ish-ndërmarrjeve shoqërore të gjejë një formë të përshtatshme të realizimit të tyre.	Gjendja mbetet e pa ndryshuar edhe këtë vit me trend të rritjes së LLA-ve dhe komuna nuk ka ndërmarr veprime për mbledhjen e LIA.	Nuk ka filluar zbatimin
15.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të siguroj mekanizma për të vërtetuar historinë e borxheve, për të konfirmuar se nuk janë bërë përshtatje të parregullta apo lëshime. Po ashtu të rishikoj vendimin/raportin për faljen/kompenzimin e borxhit. Borxhet nga pronat publike në pronësi të komunës duhet të përcillen me përpikëri, njëherit për inkasimin e të arkëtueshmeve duhet aplikuar të gjitha veprimet ligjore.	Komuna nuk ka ndërmarr masa për adresimin e këtij rekomandimi. Kjo çështje është vendosur si e pa zbatuar dhe trajtohet tek çështja Prezantim jo i saktë i llogarive të arkëtueshme në PFV.	Nuk është i aplikueshëm më
16.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të siguroj përmes menaxherit të financave se vendimet e Kuvendit Komunal zbatohen në procesin e faturimit të qirave. Po ashtu, të rishikoj faturimet e procesuara dhe aty ku ka bazë ligjore të bëhen korrigjimet e nevojshme.	Nuk kemi hasur në ndonjë rast ku nuk janë zbatuar vendimet e kuvendit.	I zbatuar

17.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të siguroj se obligimet e mbetura në fund vit të raportohen saktë në PFV dhe të gjitha informatat për faturat e papaguara dorëzohen me kohë te ZKF.	Nga mostrat e testuar kemi konstatuar se obligimet e papaguara nuk janë raportuar saktë dhe drejt në PFV dhe kishte vonesa në pagesën e tyre. Kjo çështje është vendosur si e pa zbatuar dhe trajtohet tek çështja Vonesa në pagimin e faturave dhe kostot e procedurave përmbarimore.	Nuk është i aplikueshëm më
18.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari duhet të sigurojë funksionimin e KA-së në mënyrë që Komiteti të rishikojë në mënyrë kritike planet e auditimit të brendshëm për të konfirmuar se ato bazohen në rrezik dhe t'i ofrojë sigurinë e kërkuar menaxhmentit. Gjithashtu, KA duhet të monitoroj veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e auditimit.	Ne kemi konstatuar se komiteti i auditimit nuk kishte mbajtur asnjë takim gjatë vitit.	Nuk ka filluar zbatim

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Zukë Zuka, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Lavdim Maxhuni, Drejtor i Auditimit



Elvir Krasniqi, Udhëheqës i ekipit



Senver Morina, Anëtar i ekipit



Xhevat Seferi, Anëtar i ekipit



## Shtojca I: Letër konfirmimi



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Ferizajt, për vitin 2021 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Agim Alin



Data: 25.05.2022, Ferizaj

## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>12</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>13</sup>, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

**(shkëputur nga SNISA 200)**

### **Forma e opinionit**

#### **Opinion i pa-modifikuar**

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

**Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit**

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri.

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

**Opinionit i kualifikuar**

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

**Opinionit i kundërt**

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit:

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionin e auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.



## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik.
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar.
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet.
- <sup>4</sup> 656210205 Hartimi i hartës zonale, 30,554€; 656210688 Mirëmbajtja e hapësirave publike, 19,775€; 656211308 Kompjuter llaptop, 5,250€; 65665160 Specifikacion - vgj, 200,000€; 65665160 Specifikacion - vgj, 50,000€; 65618032 Specifikacion vgj, 66,665€; 65618192 Specifikacion vgj, 341,975€; 65618192 specifikacion vgj, 40,367€.
- <sup>5</sup> Shpenzimet e shuajtjes dhe rruges per punetor te arsimit, 400€; Kompenzimi i pagave jubilarë, shuajtave dhe shp.te udhetimit per 3 persona 6,037€; Pagave jubilarë shuajtave dhe shpenzimeve te udhetimit per punetore te arsimit 1,833€; Shpenzimet e Udhetimit, shuajtave dhe pagave jubilarë per tre persona ne vlerë sipas gjykates prej 5,049.73€; shpenzimeve te rruges dhe ushqimit 400€; Kompenzimin e ushqimit dhe udhetimit per 4 persona te arsimit 1,648€; Kjo liste e perbashket prej 10 personave per borqin baze 13,132.07€.
- <sup>6</sup> 656211093 Rikonstruimi i rrjetit të ndriçimit publik, 27,100€; 65618192 Specifikacion vgj, 25,679€; 656210174 Objektet shëndetësore, 25,000€; 656210581 Rikonstruimi i rrjetit të ndriçimit publik, 20,000€; 656210671 Ndërtimi i objektit të pastërtisë, 20,000€; 656210733 Riparimi i kanalizimit fekal, 19,999€; 65618192 specifikacion vgj, 17,265€; 656210180 rikonstruimi i rrjetit te ndriçimit publik, 13,749€; 65618192 specifikacion vgj, 12,587€; 656211093 rregullimi i infrastrukturës nëntokësore dhe asfaltimi i rrugicave ne qytet, 11,813€; 656211546 rikonstruimi i rrjetit te ndriçimit, 9,500€; 656210668 ndërtimi i kompleksit te varrezat, 9,376€; 65618192 halil fazliu, 7,238€; 65674900 nsh klarino, 5,336€; 65621256 pajisje mjekësore, 4,600€; 656210531 pajisje tjera, 1,980€; 656210879 pajisje tjera, 1,936€; 656211864 pajisje tjera, 1,600€; 656210944 blerja e tokave, 1,200€; 656210168 paisje tjera, 1,200€; 656210246 paisje tjera, 1,050€; 656210736 mbyllje e avancit per para te imta, 54€; 65665160 specifikacion-vgj, 200,000€; 656210738 asfaltimi i rrugës ne zaskok, 80,000€; 65618192 specifikacion vgj, 109,000€; 65618192 pro art ing shpk, 101,247€; 656211092 asfaltimi i rrugeve dhe trotuareve ne fshatin gaçke, 100,000€; 656210020 asfaltimi i rrugës qe lidh lagjen omuraj me lagjen spahijaj ne greme dhe rrugeve te mbetura ne fshatin greme, 100,000€; 65618192 v.gjygi pnr 611/2020 nsh besa, 83,546€; 65618192 nsh dina, 77,896€; 65665160 specifikacion-vgj, 74,000€; 656210730 rikonstruimi i rrjetit te ndriçimit publik, 70,626€; 65618192 v.gjygi pnr 550/2020 emine salihi, 67,283€; 65618192 specifikacion vgj, 63,877€; 65665160 faik dhe bajram neziri, 61,348€; 656211547 rregullimi i kanalizimit ne fshatin zaskok dhe asfaltimi i rrugeve ne doganaj, 58,548€; 65618032 specifikacion-vgj, 210,849€; 656210730 rregullimi i rrjetit te ndriçimit publik, 50,000€; 656210735 ndërtimi i stacionit te autobuseve, 43,160€; 65666465 elektro vali shpk, 30,000€.
- <sup>7</sup> Llogarite e arketueshme - Tatimi ne prone 853,432.43€; Llogarite e arketueshme - Tatimi ne prone 7,896.50€.
- <sup>8</sup> PAGESA prej 67,859€ për riparimin e kanalizimit, komuna kishte shfrytëzuar mjetet e buxhetuara për shqyrtime gjeomekanika; PAGESA prej 49,998€ për riparimin dhe konstruktimin e kanalizimi, komuna kishte shfrytëzuar mjetet e buxhetuara për Asfaltimi i rruges Gj.Fishta; PAGESA prej 39,681€ për Asfaltimin e rrugëve të mbetura në qytet, komuna kishte shfrytëzuar mjetet e buxhetuara për Kolektori verior i kanalizimit fekal prej fshatit Talinoc i Muhaxhereve deri në fshatin Babush i ri, vazhdim i kolektorit ekzistues; PAGESA prej 70,627€ për rregullimin e ndriçimit publik, komuna kishte shfrytëzuar mjetet e buxhetuara për Rregullimin e rrethojave të varrezave të qytetit; PAGESA prej 50,000€ për Ndërimin e kanalizimeve nëpër fshatra, komuna kishte shfrytëzuar mjetet e buxhetuara për Shtrirjen e rrugëve me zhavorr hapja e rrugëve të reja; PAGESA prej 49,976€ për rregullimin e ndriçimit publik, komuna kishte shfrytëzuar mjetet e buxhetuara për Rregullimin e rrethojave të varrezave të qytetit; PAGESA prej 32,000€ për rregullimin e ndriçimet publik, komuna kishte shfrytëzuar mjetet e buxhetuara për Rregullimin e rrethojave të varrezave të qytetit; dhe PAGESA prej 30,554€ për hartimin e hartave zonale, komuna kishte shfrytëzuar mjetet e buxhetuara për Ndërtimi dhe funksionalizimi i zyrës për rigjenerim Urban.
- <sup>9</sup> Ndërtimi i kompleksit te varrezave te qytetit 50,000€; 656210730 Rikonstruimi i rrjetit te ndriçimit publik 70,626€; 656211706 Pjesëmarrja ne projekt me donator ujësjellës ne fshatin sojeve dardani 100,000€; 656210020 Asfaltimi i rrugës qe lidh lagjen Omuraj me lagjen Spahijaj ne greme dhe rrugëve te mbetura ne fshatin greme 100,000€; 656211008 Ujesjellsi 543,837€; 656211392 Ujesjellsi 325,584€.

- <sup>10</sup> Rregullimi i tregut të kafshëve dhe ndërtimi i strehimores për qenët endacak, projekt tre vjeçar 218,273€; Asfaltimit rrugës kryesore në fsh Cernill 499,900€; Ndërtimi i shkollës Konstandin Kristoforidhi në fsh. Nerodime, 332,526€; Riparimi i trotuareve me kubëza 250,000€; Rregullimi i kanalizimit ne fshatin Kosinë 213,953€ Furnizimi i fermerëve me sera dhe sistemin pikë pikë 205,930€; Mirëmbajtja e rrugëve 132,247€; Pastrimi dhe mirëmbajtja higjienike e objektit të komunës se Ferizajt dhe institucioneve përkatëse 245,447€; dhe Mirëmbajtja e rrugëve gjatë sezonit dimërore LLOTO IV 155,241€.
- <sup>11</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave.
- <sup>12</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit.
- <sup>13</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.